

Java Kulturore Gjermane

03-08 Tetor



Java Kulture Gjermane

3 Tetor



ORA: 17:00

STREET FESTIVAL

Në këtë event vizitorët mund të eksplorojnë stenda informuese mbi studimet, bursat dhe organizatat gjermane, të marrin pjesë në kuize dhe aktivitete kulturore, si dhe të shijojnë muzikë tradicionale bavareze dhe kulinari tipike gjermane.

PAZARI I RI (SHESHI REKREATIV) - TIRANË



ORA: 20:00

HÖR ON TOUR: TIRANA

Një natë e veçantë që bashkon DJ gjermanë dhe shqiptarë. Eventi ofron një atmosferë që pasqyron shpirtin underground të Berlinit dhe energjinë e Tiranës, duke krijuar një hapësirë gjithëpërfshirëse për komunitete të ndryshme.

TUNÈL MUSIC VENUE - TIRANË

Java Kulturore Gjermane

4 Tetor



ORA: 12:00

ON LAKE, WOW ALBANIA

Ky event sjell një përvojë kulturore dhe muzikore për të gjithë. Shfaqja e animacionit për fëmijë rikthen përrallat magjike të Vëllezërve Grimm, ndërsa performanca në piano nderon Richard Wagner dhe muzikën klasike gjermane. Mbrëmja kulmon me performancën e DJ-së me famë ndërkombëtare, Anja Schneider, e cila sjell ritmet e muzikës elektronike.

DIGA – LIQENI ARTIFICIAL – TIRANË

PROGRAMI:

12:00 – Shfaqje animacioni për fëmijë me përrallat e përjetshme të Vëllezërve Grimm. (Hirushja, Borëbardha, Rapunzel)

16:30 – 17:30 – Piano – Erlis Kucana. Një homazh për Richard Wagner dhe muzikën klasike gjermane.
Shfaqje DJ me muzikë elektronike.

19:00 – 20:00 – Pulcher

20:00 – 22:00 – Malo b2b Vassò

22:00 – 00:00 – Anja Schneider

Java **Kulturore**
Gjermane

4 Tetor

 ORA: 11:00

PREZANTIMI I LIBRIT TË ARTIT "THE RED THAT LONGS TO SOFTEN INTO ROSE"

Si pjesë e ekspozitës Homeward, artistja bashkëkohore Alketa Ramaj prezanton për herë të parë librin e saj artistik, i krijuar gjatë rezidencës në Junge Akademie Berlin. Libri eksploron vizatime ku trupi dhe gjestet ndërthuren në një proces krijues për të transformuar identitete të ngurta.

UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" – SHKODËR

4-5 Tetor

 ORA: 14:00 – 20:00

HÖR ON TOUR: TIRANA – POP UP

Ky event sjell për herë të parë në Tiranë livestream-et më të njohura të muzikës elektronike nga Berlioni. DJ të përzgjedhur performojnë live dhe transmetohen globalisht, duke lidhur skenën muzikore të Tiranës me komunitetin ndërkombëtar. Eventi ofron audiencë globale për artistët shqiptarë dhe e pozicionon Tiranën si një qendër kreativiteti dhe inovacioni.

TUNÈL MUSIC VENUE – TIRANË

Java **Kulturore**
Gjermane

5 Tetor



ORA: 19:00

SHFAQJA E FILMIT: "DY ME NJË"

Filmi, me regji të Natja Brunckhorst, është një komedi për dashurinë, miqësinë dhe drejtësinë. Tre miq në Halberstadt zbulojnë rastësisht miliarda marka të vjetra të RDGJ-së dhe përpiqen t'i kthejnë në mallra dhe sende të çmuara. I bazuar në ngjarje të vërteta, filmi feston një kohë kur gjithçka dukej e mundur.

KINEMA MILLENNIUM - TIRANË

Java **Kulturore**
Gjermane

6 Tetor



ORA: 11:00

"MEKANIZMA TË DËSHIRËS KRIJUESE" - LIGJËRATË NGA STEPHAN KALUZA

Artist nga Düsseldorf me mbi 30 vite përvojë në tregun e artit, do të trajtojë ndërthurjen mes artit dhe tregut të artit, sfondin teorik dhe filozofik të artit bashkëkohor, si dhe mekanizmat e krijimtarisë brenda tregut global, nga Baseli në Londër dhe Nju Jork.

Gjuha e aktivitetit: Gjermanisht, me përkthim në shqip.
I hapur për të gjithë të interesuarit.

Regjistrimet: buero@honorarkonsul-albanien-nrw.de

UNIVERSITETI I ARTEVE - TIRANË

Java **Kulturore**
Gjermane

7 Tetor



ORA: 20:00

KONCERT - RECITAL "FROM BACH TO BLUES". CAROLINE ADOMEIT (VIOLINË) DHE FATMA SPAHIU (PIANO)

Ky koncert sjell një udhëtim nga Bach dhe Ravel tek arranxhime moderne, vepra shqiptare dhe blues, duke ndërthurur klasiken me bashkëkohoren. Caroline Adomeit do të zhvillojë edhe një masterclass për studentët e violinës në bashkëpunim me Fakultetin e Muzikës.

HOLLI KONCERTOR, TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR - TIRANË

Java Kulturore Gjermane

8 Tetor



ORA: 18:30

**KONCERT CROSSOVER - ME RALF BENSCHU (SAKSA-
FON) & ELHAM PEYMAN (PIANO)**

Artistët sjellin në Shkodër një koncert të veçantë me një program të pasur që përfshin Rutter, Iturralde, Piazzolla, Naulais, Bozza, Schütz dhe këngë popullore shqiptare. Repertori ndërthur stile të ndryshme muzikore, nga pjesë të qeta te ritme plot energji.

TEATRI "PETRO MARKO" – VLORË



ORA: 14:00

FILM ME METRAZH TË SHKURTËR: "PËRJETIMET QË NA LIDHIN"

Filmi është realizuar me nxënësit e shkollës "Said Najdeni" në Peshkopi, duke pasqyruar përvojat e tyre nga kampi veror ndërkombëtar në Schwäbisch Gmünd (Gjermani). Nxënësit ndajnë përvoja mbi miqësinë dhe bashkëpunimin ndërkulturor, dialogun dhe respektin, sfidat e mediave dhe "fake news", mbrojtjen e mjedisit dhe aktivitetet kulturore të përbashkëta.

PALLATI I KULTURËS – PESHKOPI